



Prishtinë, 12.11 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1318\_2020

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084),
- Dispozitën e Nenit 16, dhe 19 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085),
- Nenin 16 të licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kërkesën e KOSTT të datës 1 tetor 2020 për aprovimin dokumenteve:
  - o *Metodologjia për Rregullat për dimensionimin e FRR në Blokun LFC AK, dhe*
  - o *Procedura për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese dhe bllokut AK,*

në seancën e mbajtur me 12 nëntor 2020, nxori këtë:

## V E N D I M

- I. **Aprovohet dokumenti *Metodologjia për Rregullat për dimensionimin e FRR në Blokun LFC AK***
- II. **Aprovohet dokumenti *Procedurë për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese dhe bllokut AK***

## Arsyetim

Me 26.11.2019 operatorët e sistemit të transmetimit të Kosovës dhe Shqipërisë, përkatësisht KOSTT dhe OST kanë nënshkruar Marrëveshjen për themelimin e Bllokut LFC AK.

Me 21.08.2020 KOSTT ka dërguar në ZRRE për aprovim dokumentet *Metodologjia për rregullat për dimensionimin e FRR në Bllokun LFC AK, dhe Procedurë për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese dhe bllokut AK*. Paraprakisht dokumentet janë nënshkruar nga dy operatorët e sistemit të transmetimit KOSTT dhe OST dhe janë dërguar për



dijeni në Entin Rregullator të energjisë (ERE) dhe për aprovim në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE);

ZRRE ka shqyrtuar, komentuar dhe vlerësuar dokumentet, dhe konsideron se i plotësojnë kriteret e nevojshme për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervës për rregullim, dhe e ka parë të arsyeshme që të Aprovohen dokumentet *Metodologjia për rregullat për dimensionimin e FRR në Bllokun LFC AK*, dhe *Procedurë për shkëmbimin dhe aktivizimin e rezervave për balancim të zonave rregulluese dhe bllokut AK*.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, palët e pakënaqura mund ti drejtohen Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

- Vendimi dhe dokumentet iu dërgohen:
- Të licencuarit – KOSTT SH.A,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji,

**Bordi i ZRRE-së;**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar